

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

622-24-3109-5-1-1/C1602

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik EdiBau- ing SH.P.K.; N.N.T. Etniku ; VE ING, UKË BYTYÇI PN, PRIZREN, (në vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambijentit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit. Kontratë kornizë trevjeqare me numër identifikues: **622-24-3109-5-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim:

Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambijentit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit. Kontratë kornizë trevjeqare

Nr.	Grupi
1	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambijentit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit. Kontratë kornizë trevjeqare

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 26. 03. 2025 dhe përfundon me 25. 03. 2028

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë _____ ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë Shkollat e Komunës së Prizrenit

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është 2,151.93 € (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e tre cent) është çmimi i peshuar me të cilin është bërë vlerësimi i ofertave ndërsa

Kontrata do të lidhe dhe do të realizohet sipas çmimeve për njësi të ofruara nga OE dhe totali i këtyre çmimeve për njësi është 6,365.50 € (gjasht mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pes euro e pesëdhjetë cent çmim për njësi)

Vlera e parashikuar e kontratës për 36 muaj është 1,500,000.00 € (një milion e pesëqind mijë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	25.03.2025
Vula:	

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2025
Vula:	

Për Kontraktorin

Emri:	Bujar Spahija
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2025
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA
622-24-3109-5-1-1/C1602

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 36 muaj kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Luljeta Veselaj Gutaj Menaxheri i Kontratës është: Veron Aliu
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së

		zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-3109-5-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik EdiBau- ing SH.P.K.; N.N.T. Etniku**
; VE ING, UKË BYTYÇI PN, 20000, PRIZREN, Kosovë

E-mail: **edibauing@gmail.com**

Personi kontaktues: **Bujar Spahija**

Telefoni: **044/144454**

049/380600

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri **1.**

Emri i kompanisë: **N.N.T. " Etniku "**

Numri fiskal: **600366323**

Vend-Selia: **Samadrexhe, 23060, Suharekë, Kosovë**

Partneri **2.**

Emri i kompanisë: **" EdiBau- ing " SH.P.K.**

Numri fiskal: **601597779**

Vend-Selia: **UKË BYTYÇI PN, 20000, PRIZREN, Kosovë**

Partneri **3.**

Emri i kompanisë: **VE ING**

Numri fiskal: **811898602**

Vend-Selia: **Prishtinë, 10000, Prishtinë, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-3109-5-1-1

Titulli i kontratës: Rregullimi dhe mirmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit. Kontratë kornizë trevjeqare

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Rregullimi dhe mirmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit. Kontratë kornizë trevjeqare

3. Çmimi total i tenderit është:

2,151.93 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK



Republika e Kosovës

Republika Kosovo- Kosovo Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria Komunale e Arsimit

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

OBJEKTI: Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit

A	Punët pregatitore, demolimi, dheut dhe zhavorit					kategoria A Çmimi i peshuar =10 % e vlerësimit
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi me TVSH	Çmimi/njësi i peshuar	Totali/cmimi i peshuar
1	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjestimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	m'	1	10.00	1.00	1.00 €
2	Pastrimi i tërësishëm i objektit dhe terenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethojat, mbeturinat inerte dhe ambalazhet e paketimet e materialeve, etj.	komplet	1	200.00	20.00	20.00 €
3	Demolimi i sipërfaqeve nga betoni dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m²	1	2.50	0.25	0.25 €
4	Demolimi i kubzave dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m²	1	3.00	0.30	0.30 €
5	Demolimi i ansoreve dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m'	1	3.00	0.30	0.30 €
6	Demolimi i rrethojave ekzistuese nga materialet e ndryshme dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m'	1	5.00	0.50	0.50 €
7	Demolimi i ulseve nga materialete ndryshme dhe bartja e materialit te demoluar deri ne deponi	cope	1	30.00	3.00	3.00 €
8	Demolimi i mureve rrethuese nga betoni armuar dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m'	1	15.00	1.50	1.50 €

9	Demolimi i shtreses se asfaltit dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m ²	1	5.00	0.50	0.50 €
10	Germimi i dheut te kategorise se III dhe IV per hapjen e themeleve per punimin e rrethojave dhe trasnporti i dheut deri ne deponi.	m ³	1	5.50	0.55	0.55 €
11	Ngjeshja e dheut me mekanizem CILINDER deri ne arrijten e kompakteses se nevojshme te dheut per punimin e themeleve.	m ²	1	1.00	0.10	0.10 €
12	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit per nivelizimin e komplet pjeses se terenit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/125mm, t=50 cm .	m ³	1	20.00	2.00	2.00 €
13	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm ne pjeset e parapregatitura me trashësi sipas nevojës dhe ngjeshja me cilindër	m ³	1	22.00	2.20	2.20 €
14	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit fraksion 0/31.5mm, ne pjeset e parapregatitura dhe ngjeshja me cilindër.	m ³	1	23.00	2.30	2.30 €
15	Furnizimi, bartja si dhe punimi i rërës së imët dhe nivelizimi i saj prej gurit të thyer zhavorit 4-8mm me trashësi t=10cm.	m ³	1	25.00	2.50	2.50 €
16	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës sipas nevojës neper siperfaqet e parapregatitura	m ³	1	25.00	2.50	2.50 €
17	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit ne FR III nen themele.	m ³	1	24.00	2.40	2.40 €
Total :				419.00	41.90	41.90 €

B	Punët e BetonArmesë, Rrethojës, Asfaltit, Tartanit, Kubazave -					kategoria B Çmimi i peshuar =65 % e vlerësimit
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi me TVSH	Çmimi/njësi i peshuar	Totali/cmim i peshuar
1	Furnizimi me material si dhe betonimi i shtreses rrafshuese nga betoni i paarmuar C-15/20	m ³	1.00	85.00	55.25	55.25 €

2	Furnizimi me material, kallëpimi si dhe betonimi i themeleve dhe shtyllave të rrethojës me beton C-25/30.	m³	1.00	135.00	87.75	87.75 €
3	Furnizimi me material si dhe betonimi i cokulles së rrethojës me beton C-25/30.	m³	1.00	135.00	87.75	87.75 €
4	Furnizimi me material dhe punimi i mureve mbrojtëse me beton të armuar C-25/30 duke përfshirë pahitë, ngjeshjen me vibrator adekuat, vuarjen në vepër dhe mirëmbajtjen e tij. Llogaria për m³ të betonit të vendosur.	m³	1.00	135.00	87.75	87.75 €
5	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shkallëve dhe rampave/pjerrinave tek hyrje/daljet në objekt në nivelin e përdhësës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Pozicionet duhet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokën/zhavorin e ngjeshur duke u lidhur me muret perimetrike të themelit me anë të ankerave të lënë më parë. Thellësia e fondimit -0.60. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m³	1.00	155.00	100.75	100.75 €
6	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe montimi i armaturave S-500, sipas detajeve të armimit. Për punimin e themeleve, cokulles ose mureve. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet të jenë të pastra nga korrozioni.	kg	1.00	2.50	1.63	1.63 €
7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rrethojës nga çeliku në murin rrethues në lartësi deri në 150 cm, duke u vendosur në shtylla katrore 60x60x2.5 mm. Shtyllat metalike vendosen çdo 2m distance, dhe profile gjatësore 20x20 mm, ndërsa tërthore 40x20 mm me trashësi në murit min. 2.0mm. Materiali çelik me ngjyrë që përcaktohet nga organi mbikqyrës, të vendosen kapaket e plastikes në çdo profil.	m	1.00	90.00	58.50	58.50 €

8	Furnizimi me material si dhe vendosja e rrethojës . Rrethoja është nga konstruksioni metalik (profilët metalike) si dhe mbushja me rrjetë çeliku. Te punohet sipas vizatimit. Shtyllat janë 80x80x3mm-te mbyllën me kapakë në vendet ku ka nevojë, këter horizontalet kryesore janë 60x60x3mm. Mbushja(rrjeta) të jetë Ø8 15/15 cm. Te parashihet ankerimi në beton i shtyllave vertikale sipas vizatimeve. Te parashihet ngjyrosja e rrethojës në dy shtresa sipas standarteve si dhe ngjyrosja kundër korezionit, nuancën e ngjyrës e përcakton organi mbikëqyrës. Lartësia e rrethojës është h=500cm , 50 cm e ankeruar në themelin BA. Te punohet sipas detaleve të paraqitura në projekt.	m ²	1.00	53.00	34.45	34.45 €
9	Furnizimi dhe vendosja e derës rreshqitese të oborrit me gjeresi 300 deri në 600cm dhe lartësi 200cm, nga profilët e çelikut. Në cmim të llogariten të gjitha materialet dhe pozicionet për punimin e derës dhe funksionimin normal të sajë	cope	1.00	500.00	325.00	325.00 €
10	Furnizimi, shtrirja, planifikimi dhe kompaktimi (me mjete adekuate) i shtresës së Asfaltbetonit AB-0/16mm, t=10 cm të tereneve sportive dhe meremetimi i atyre ekzistuese	m ²	1.00	25.00	16.25	16.25 €
11	Përgaditja e terrenit, pastrimi tij si dhe përgaditja për aplikimin e prajmerit kontaktues.	m ²	1.00	5.00	3.25	3.25 €
12	Pas përgaditjes së nivelizimit të terrenit duhet të aplikohet shtresa lidhëse ATHLON ose SPORTRACK SC SC	m ²	1.00	45.00	29.25	29.25 €
13	Instalimi në mënyrë makinerike e granulatit të zi 1-4mm të lidhës me lidhësen SPORTRACK SC pastaj duhet të përfundohet me monoliton me trashësi 11 mm	m ²	1.00	60.00	39.00	39.00 €
14	Sperkatja e tërë sipërfaqes me granulat të kuq EPDM me trashësi 0.5-1.5mm pastaj të lidhet me sperkates të kuq SPORTRACK SC RED dy here	m ²	1.00	20.00	13.00	13.00 €
15	Furnizimi dhe vendosja e gureve skajorëve nga betoni i klases C25/30 në cmim të përfshihen të gjitha punimet deri në përfundim të pozicionit	m ²	1.00	14.00	9.10	9.10 €

16	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e kubëzave nga betoni i klases C25/30 me l=8cm. Në pozicion përfshihet edhe mbushja e fugave me rërë.	m ²	1.00	25.00	16.25	16.25 €
17	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e pllakave Terrazo Terrastone me dimensione 60x40x6cm. Në çmim kalkulohen edhe vendosja e distancerave t=3mm, si dhe fuga. Produkti duhet të posedojë atestet të kontrollit të cilësisë sipas EN:13748-2 sipas CPD të markuar me markë CE.	m ²	1.00	57.00	37.05	37.05 €
18	Furnizimi me pllaka për hapsira të jashtme për persona të verber me pllaka 40x40x6 cm, ngjyre e verdhe bazuar në standardet dhe alfabetin për persona të verber, e kalibruar, e rrezuar dhe impregnuar ose të ngjashme, në vlerat referuese të standardeve evropiane EN 13748-2:2004 Montimi tyre duhet të përmbahet udhëzimeve teknike për këtë lloj materiali dhe gjithmone sipas udhëzimeve të projektantit, prodhuesit, si dhe organit mbikqyres për dizajn dhe ngjyre, si dhe ky produkt karakterizohet me këto pika të veqanta. Prodhuesi të jetë i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë) për sistem hermetik të makinerisë prodhuese. Produkti të plotësojë standardet në vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti të posedojë shenjen CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2. Në çmim të përfshihet dhe vendosja në vepër e pllakave me të gjitha elementet përcjellëse.	m ²	1.00	17.00	11.05	11.05 €
Total :				1,558.50	1,013.03	1,013.03 €

F. Ayari

C	Punët e Ndryshme si dhe Elektrikës, Tokëzimit, Kanalizimit, Drenazimit					kategoria c Çmimi i peshuar =25 % e vlerësimit
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi me TVSH	Çmimi/njësi peshuar	Totali/cmimi peshuar
1	Punimi dhe vendosja e konstruksionit metalike te shkalleve evakuese dhe basamakeve nga llamarina e brinjezuar me trashesi 4 mm ne vendin e dhene sipas projektit kryesor. Punimi i konstruksionit te behet prej profileve te celikut te salduara dhe ankeruara ne mes vete dhe fundamentin nga beton armeja (si ne projek) bazuar ne llogarine strukturale. Te njejti te ngyrosen me ngjyre baze qe mbron nga korozioni dhe dy shtresa ngjyre yndyrore. Ne llogari te parashifen skelet, mjetet, elementet lidhese dhe te gjitha punet dhe materialet tjera te nevojshme per ekzekutim. Llogaria te behet per kg te materialit te perdorur .	kg	1.00	5.80	1.45	1.45 €
2	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllatose tek se shkallëve emergjente me trashesi te pllakes t=20cm,ashtu siq eshte parapare me projekt. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 . Pozicionet duhet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokën/zhavorin e ngjeshur duke u lidhur me muret perimetrike të themelit me anë të ankerave të lënë më parë. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit	m ³	1.00	145.00	36.25	36.25 €
3	Germimi I dheut te kategorise se III dhe IV , ne thellsi h=30cm tek pjesa e gjelbrimit dhe trasnporti I dheut deri ne deponi.	m ³	1.00	5.00	1.25	1.25 €
4	Furnizimi, transporti, shtruarja , përpunimi, rrafshimi me kujdes si dhe ngjeshja e dheut humosor ne pjesën e planifikuar të gjelbrimit.	m ³	1.00	15.00	3.75	3.75 €
5	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit per parqe me rritje te shkurte, duke llogaritur afersisht 4kg/ori, duhet llogaritet edhe ujitja e barit gjat mbjelljes.	m ²	1.00	2.50	0.63	0.63 €

7000

6	Furnizimi, transporti dhe mbajtja e drunjeve dekorativ të llojit Fraxinus Globosa me substrat të vetin	copë	1.00	50.00	12.50	12.50 €
7	Furnizimi dhe montimi i ulëseve të oborrit.	copë	1.00	300.00	75.00	75.00 €
8	Furnizimi dhe instalimi i koshave të mbeturinave, ankerimi i tyre për bazamentin e betonit.	copë	1.00	250.00	62.50	62.50 €
9	Furnizimi me material si dhe ngjyrosja e vijave për zhvillimin e lojërave sportive, keto tri vija do të jenë me nuanca të ndryshme, të punohen sipas standardeve.	m'	1.00	2.70	0.68	0.68 €
10	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e rrethojës së jashtme ekzistuese, ku paraparakishte duhet të bëhet riparimi i saj në pjesët e demtuara (vazhdimi-saldimi i profileve), gryrja e shtraseve të ngjyres ekzistuese, ngjyrosja duhet të bëhet në dy shtresa, një shtresë kundër korozionit dhe një shtresë finale, nuanca e ngjyres finale e cakton investitori, lartësia e rrethojës është 2 m.	m2	1.00	9.00	2.25	2.25 €
11	Furnizimi me material si dhe vendosja e portave për futboll shkollor, portat të jenë nga metali, a të jenë levizëse me dimensione 3x2m, të ketë të vendosur rrjetën adekuate.	copë	1.00	740.00	185.00	185.00 €
12	Furnizimi dhe montimi kabllor elektrike nga KKESH deri KESH PP00 5x4mm ² .	m	1.00	20.00	5.00	5.00 €
13	Furnizimi dhe montimi në mur i kuadrit kabllorik për kyçje KKK me 3 copë siguresa shkrirëse NV/NH gl me rrymë nominale 63 A. Tipi i kuadrit dhe karakteristikat e tij duhet të përgjigjen kushteve të ndërmarrjes elektrodistributive. Komplet me zbarër për barazimin e potencialit dhe për shqyrtim dhe i gatshëm për punë.	copë	1.00	95.00	23.75	23.75 €
14	Furnizimi dhe montimi i gypit nga plastika e fortë me diametër Ø100mm nga pika e kyçjes së rrjetës së qytetit e deri te kuadri kabllorik për kyçje dhe nga KKK deri te KKESH, nëpër të cilin duhet të futet kablli furnizues komplet me punët e tokës.	m	1.00	15.00	3.75	3.75 €

15	Furnizimi dhe montimi i kuadrilit kryesor shpërndarës KKS.H. nga llamarija e plastifikuar me mbrojtje IP 54 për montim në murin e objektit, me vend të mjaftueshëm për këto elemente:	copë	1.00	400.00	100.00	100.00 €
16	Siguresa automatike C40 A së bashku me bazën për montim	copë	1.00	30.00	7.50	7.50 €
17	siguresa automatike L 2/1p	copë	1.00	25.00	6.25	6.25 €
18	Llamba për sinjalizim 5W	copë	1.00	17.00	4.25	4.25 €
19	Materiali tjetër montues(zbarra, borna rendore, përcues për lidhje,etj)	paushall	1.00	50.00	12.50	12.50 €
20	Furnizimi dhe montimi i kabllos së bakrit H05VV-F- 3x2.5mm ² i cili përdoret nga kutitja shpërndarëse deri te REFLEKTORET.	m	1.00	6.00	1.50	1.50 €
21	Furnizimi dhe montimi i kontaktorëve dyëpolar CN16 për reflektorë	copë	1.00	20.00	5.00	5.00 €
22	Furnizimi dhe montimi i reflektoreve per ndriçim, montimi ne mbajteset speciale, reflektimi kah poshte, IP 65, shtepiza dy pjeseshe nga alumini i derdhur, me PANEL LED 200W.	copë	1.00	175.00	43.75	43.75 €
23	Furnizimi dhe montimi i shtylles se metalit h=4m, tek pjesa e parkingut apo hapsirave tjera, e galvanizuar dhe e ngjyrosur me ngjyre te plastifikuar.	copë	1.00	400.00	100.00	100.00 €
24	Hapja e kanalit me dimensione 0.40X0.80	m ³	1.00	5.00	1.25	1.25 €
25	Furnizimi dhe shtrirja e gypit dy shtresor Ø63	m'	1.00	10.00	2.50	2.50 €
26	Hapja e gropes 0.80X0.80X0.80m, furnizimi me beton per punimin e bazamnetit te shtylles duke perfshire dhe gypin Ø250	copë	1.00	350.00	87.50	87.50 €
27	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit per verejtje	m'	1.00	2.00	0.50	0.50 €
28	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit per tokezim 25X4mm	m'	1.00	3.00	0.75	0.75 €
29	Furnizimi dhe shtrirja e kabllit PYY 4X16mm Cu	m'	1.00	4.00	1.00	1.00 €
30	Furnizimi dhe montimi i kabllit 3X1.5mm nga drita deri te pjesa lidhese	m'	1.00	5.00	1.25	1.25 €

Handwritten signature

31	Furnizimi dhe montimi i Liambes 40W e LED teknologjisë e prodhimit evropian, nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet të plotësojë standardet Evropiane sipas direktivave të BE, siq janë: EN 60598-2-3, EN 55015, EN 61347-2-13:2014, EN 61347-1-2008/A2:2014, EN 62493:2010, EN 1547:2009, EN 61000-6-2:2005, EN 61000-6-3:2007, CE LVD, CE EMC, RoHS, ENEC, LM80, IK10	copë	1.00	150.00	37.50	37.50 €
32	Punimi i tokëzimit me shirit FeZn 20x3mm me saldimin për armature në çdo 3 m si dhe me lidhje të vertikaleve dhe të OKK. Paguhet për (m).	m	1.00	7.00	1.75	1.75 €
33	Furnizimi dhe montimi : - mbajtësi i shiritit NGO-20	copë	1.00	25.00	6.25	6.25 €
34	Kryçëzori NGO-52	copë	1.00	15.00	3.75	3.75 €
35	Shtërnguese NGO-16	copë	1.00	18.00	4.50	4.50 €
36	Sonda me gjatësi l=1.5m Fe/Zn	copë	1.00	30.00	7.50	7.50 €
37	Gërmimi i dheut për hapjen e kanalit dhe pushtave, nivelimi i kanalit pas gërmimit, mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar me ngjeshja në çdo 30cm, gërmimi të behet me thellësi sipas terrenit për ramje të gravitetit. Në çmimi të llogaritët vendosja e pahive siguroese kur kanali kalon thellësinë 140cm, matjet e gjeodezike/ nivelet sipas terrenit ekzistues dhe kyçjes në ndërtës/rrjet, largimi i ujerave nëntokësore sipas nevojës. Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar të lartësisë së mbetur në shtresa prej 30cm me ngjeshje përkatëse. Dheu i tepërt të barte në dopninë e parapare nga investitori. Llogarite në metër kub.	m ³	1.00	6.00	1.50	1.50 €
38	Furnizimi, vendosja dhe planifikimi rërës mbi dhe nën tuba në trashësi min. 30cm dhe rreth gypit. Llogaritet në metër kub të mbushur.	m ³	1.00	20.00	5.00	5.00 €
39	Hapja e vrimave në mure sipas projektit apo kërkesës së organit mbikqyrës në pikat e caktuara.	copë	1.00	40.00	10.00	10.00 €

F. Lajçi

40	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i pusetave Ø800mm me elemente te gatshme nga betoni MB-40, pjesa konike e pusetës te përforcohet me beton. Në çmim të llogariten pjesët konike si dhe punimi i kinetës me beton (sipas detalit në projekt) me thellësi sipas niveleve nga terreni, shkallet metalike Ø22mm, kapaku dhe unaza nga materiali Kompozit B125 me aftësi mbajtëse Q=60I dhe te gjitha pune e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite ne cope.	copë	1.00	450.00	112.50	112.50 €
41	Furnizimi, transporti i dhe punimi i konusav te parafabrikuara nga betoni MB-40 me diamter Ø1000/600mm,	copë	1.00	70.00	17.50	17.50 €
42	Furnizimi, transporti i dhe montimi i gypit HDPE te brinjezuar SN8 kualitetit te larte. Ne çmim te llogaritet edhe fazoneria komplet. Llogaritet ne meter gjatesi. Diametri i Gypit: Ø250mm	m'	1.00	15.00	3.75	3.75 €
43	Furnizimi, transporti i dhe montimi i gypit HDPE te brinjezuar SN8 kualitetit te larte. Ne çmim te llogaritet edhe fazoneria komplet. Llogaritet ne meter gjatesi. Diametri i Gypit: Ø200mm	m'	1.00	13.00	3.25	3.25 €
44	Furnizimi, transporti i dhe montimi i gypit HDPE te brinjezuar SN8 kualitetit te larte. Ne çmim te llogaritet edhe fazoneria komplet. Llogaritet ne meter gjatesi. Diametri i Gypit: Ø125mm	m'	1.00	10.50	2.63	2.63 €
45	Furnizimi, transporti i dhe montimi i gypit HDPE te brinjezuar SN8 kualitetit te larte. Ne çmim te llogaritet edhe fazoneria komplet. Llogaritet ne meter gjatesi. Diametri i Gypit: Ø110mm	m'	1.00	9.50	2.38	2.38 €



F. S. S. S.


46	Gërmimi me dorë dhe me makina, dhe është i kateg. së III-të dhe IV-të në proporcion 90% dhe 10%. Tëhet e kanaleve duhet të gërmohen në formë të rregullit dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2,5 m', kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.	m ³	1.00	6.00	1.50	1.50 €
47	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m ² të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ²	1.00	1.50	0.38	0.38 €
48	Furnizimi dhe montimi i gypave të drenazhimit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme fazonike Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet. Në cmim të kullohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rrjeti i drenazhimit si dhe percjellja e punimeve me instrument gjeodezik. Diametri: Ø125 mm	m	1.00	8.50	2.13	2.13 €
49	Furnizimi dhe montimi i gypave të drenazhimit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme fazonike Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet. Në cmim të kullohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rrjeti i drenazhimit si dhe percjellja e punimeve me instrument gjeodezik. Diametri: Ø160 mm	m	1.00	14.00	3.50	3.50 €
50	Furnizimi dhe montimi zhavorit drenazhues përgjatë perimetrit të objektit të gypit të drenazhes deri në lartësinë e duhur zhavorit të drenazhimit duke përfshirë edhe vendosjen e bazamentit nga dheu i përdoruesit në fund të gypit, sipas detalit në projekt	m ³	1.00	22.00	5.50	5.50 €
51	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i pusetave Ø600mm me elemente të gatshme nga betoni MB-40, pjesa konike e pusetës të përfundohet me beton. Llogaritja në copë	copë	1.00	300.00	75.00	75.00 €
Total :				4,388.00	1,097.00	1,097.00 €

Ferry

REKAPITULLIMI		Çmimi total për njësi	Çmimi total i peshuar
A	Punët pregatitore, demolimi, dheut dhe zhavorit - 10%	€ 419.00	€ 41.90
B	Punët e BetonArmesë, Rrethojës, Asfaltit, Tarlanit, Kubazave - 65%	€ 1,558.50	€ 1,013.03
C	Punët e Ndryshme si dhe Elektrikës, Tokëzimit, Kanalizimit, Drenazhimit - 25%	€ 4,388.00	€ 1,097.00
TOTAL		6,365.50 €	2,151.93 €

OFERTAT DO TË VLERËSOHEN BAZUAR NË ÇMIMIN E PËRGJITHSHËM TË PESHUAR

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I OE:	"Edibau-ing"Shpk & N.N.T. "Etniku" & VE ING SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQESUESIT TË OE:	Bujar Spahija
NËNSHKRIMI I PËRFAQESUESIT TË OE:	
DATA:	19.06.2024
VULA :	





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **136956**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **EdiBaU- Ing SH.P.K. & Tahir Bugari B.I. & VE ING SH.P.K**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rregullimi dhe mirembajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunen e Prizrenit.Kontrate kornize trevjeqare.**

Nr. prokurimit: 622-24-3109-5-1-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartçekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartçekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **150,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **150,000.00€** siç është lartçekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1127 ditë kalendarike prej **25.03.2025** deri më **25.04.2028**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 25.03.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

I nderuar klient !

Ju jemi mirënjohës që keni zgjedhur Kompaninë e sigurimeve "K.S. Elsig" për sigurimin e garancive për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve kontraktuese nga veprimtaria e juaj e regjistruar me nr. të biznesit.

Deklarata e klientit

1. Personi që kanë nënshkruar këtë kërkesë është informuar nga siguroesi dhe është pajtuar, që:
- të dhënat personale të kësaj kërkesë, së bashku me të dhënat tjera, do të përpunohen dhe përdoren nga siguroesi, në lidhje me sigurimin e kontraktuar, për qëllime statistikore dhe për qëllime të hulumtimit (verifikimit)/raportimit në Regjistrin e Kreditor të Kosovës (RKK) si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.
- siguroesi do të ruaj të dhënat personale me sigurinë e nevojshme në regjistrin, ku këto të dhëna do të strukturohen me ndihmën e kartelave apo përmes ndonjë baze elektronike të të dhënave si dhe do të raportohen në regjistrin e Kredive të Kosovës. - në këto të dhëna personale të përpunuara, personat e tretë nuk do të kenë qasje, përveç nëse është fjala për organet shtetërore kur kjo është e sanksionuar me ligj, si dhe për personat që përpunojnë të dhënat nën udhëheqjen e kompanisë K.S. "ELSIG" sh.a., apo kompanive partnere të KS "ELSIG" sh.a.
2. Personat që nënshkruajnë këtë policë, vërtetojnë se: vullnetarisht kanë dhënë informata personale për vetveten, si kusht i domosdoshëm për kontraktimin e këtij sigurimi, dhe se janë të pajtimit, që siguroesi të përpunojë ato të dhëna dhe t'u lejojë personave të tretë në pajtim me pikën 1 të këtij dokumenti, qasje në to.
3. Kontraktuesi i sigurimit vërteton me nënshkrimin e tij, se: është plotësisht i aftë dhe se nuk ka asnjë kufizim për hyrjen në marrëdhënie kontraktuese.
4. Personat që kanë nënshkruar këtë policë vërtetojnë se: në lidhje me këtë policë, nuk ka asnjë marrëveshje gojore shtesë.

Detyrimet e të siguruarit:

Të paguaj preminë e sigurimit kur e lidh kontratën e sigurimit : Të informojë siguroesin për rastin e siguruar afatit prej 3 ditësh: Të informojë siguroesin edhe atëherë kur kërkesa për dëmshpërblim kundër tij të jetë paraqitur nëpërmjet gjykatës, kur të jen nën arrest si dhe kur të ketë filluar procedura për sigurimin e provave: Të dërgojë siguroesit dëshmitë e nevojshme për vlerësimin e shkaktarit dhe të natyrës së dëmit.

Detyrimet e siguroesit :

Pas ndodhjes të rastit të siguruar siguroesi është i detyruar: Të njoftojë të siguruarin me informacionet përkatëse lidhur me kushtet dhe tarifën e sigurimit të garancive : Të ndërmerre, bashkë me të

siguararin, mbrojtjen nga kërkesat e pa mbështetura ose të tepëra për kompensimin e dëmit: Të plotësojë kërkesat e bazuara për kompensimin e dëmit. Të përpunojë dhe të paguaj dëmin në afatin prej 15 ditësh pasi është bërë kompletimi i lëndës me dokumentacionin e nevojshëm. Pjesën përbërëse të kësaj police janë kushtet e sigurimit. Në rast kontesti lidhur me dëmin që ka ndodhur e që mbulohet me këtë policë, kompetente është gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

Dear Customer!

We are very grateful that you have chosen I.C. "ELSIG" Insurance Company for Safeguards concerning the claims that can occurred to contractual party caused in the course of your registered business.

Customer statements

1. Persons undersigned in this policy are informed and agreed, that: - personal data in this policy, and all other data, will be processed and used by insurer, related to contracted insurance, and for statistical purposes and for purposes of review (verification)/report in the Loan Register of Kosovo (RKK) and also for the transfer to the third party with the purpose of claim treatment.
- The insurer will keep all the personal data recorded with necessary safety in registers and all these data will be structured with the help of cards or through other electronic databases and also will be reported in the Loan Register of Kosovo. - in these processed personal data, third parties do not have approach, except the state authorities when this is sanctioned by law, as well as persons that process data under the leadership of the company I.C. "ELSIG" j.s.c., or partner companies of IC. "ELSIG" j.s.c.
2. Persons undersigned in this policy, certify that: voluntarily provided personal information about themselves, as necessary condition for the contraction of this insurance, and agreed that the insurer will process those data and will allow access in those to third parties in accordance with paragraph 1 of this document.
3. Insurance Contractor with his/her signature certifies that: is fully capable and that there is no restriction on entry in contractual relations.
4. Persons undersigned in this policy certify that: regarding this policy, there is no additional oral agreement.

Policyholder's obligations

To pay the insurance premium when he/she signs the insurance contract: To inform the insurer for the insured case within three days: To inform the insurer even when the claim for the compensation is submitted through the court, when under arrest as well as when the procedure for evidence collection has begun: To submit to the insurer necessary evidence for the claim evaluation and its nature and cause.

Insurer's obligations

After the claim has occurred for an insurable event, the insurers obliged to: To inform the insured with appropriate information concerning the terms, conditions and the tariffs for Safeguards insurance. Together with the insured needs undertake the necessary measures in order to prevent unnecessary and/or excessive claims for compensation: To meet the requirements needed to compensate the claim: The insurer needs to review and compensate the claim no later 15 days after the file has been completed with the necessary information: Integral part of this policy are the insurance terms and conditions mentioned above. In the case of the contest related to the loss or damage covered with this policy, competent court is the court in the territory where the insurance contract is signed.

Paraqitja e dëmeve / Claim Handling Office

Drejtoria & Filiali në Prishtinë / Branch rruga :
Tringë Ismajli nr. 3
Tel.038 / 221 - 114: fax 038 / 221 - 115
e - mail : office@kselsig.com

Filiali / Branch :

Mitrovicë Tel.044 / 381 - 790	Pejë Tel.049 / 810 - 847
Ferizaj Tel.044 / 655 - 678	Prizren Tel.044 / 174 - 098
Gjakovë Tel.044 / 760 226	Gjilan Tel. 044 / 212 -378